

# **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**

## **“Rejuvence” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 07.03.2024, unë i poshtëshënuari;

Brahim Shoshi, i datëlindjes 06.02.1987, lindur ne Bajram Curri dhe banues në Rruga Jordan Misja, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal, I70206067L, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqérinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Rejuvence” shpk.**

### **Neni 1.**

#### **Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin **“Rejuvence” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

### **Neni 2**

#### **Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### **Neni 3**

#### **Selia**

Shoqëria **“Rejuvence” shpk** e ka seline në adresë: Rruga Irfan Tomini Nr 1, kati perdhe Njesia 5, Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 4**


#### **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarise për shoqërime **“Rejuvence” shpk** është: është kryerja e të gjitha shërbimeve të një poliklinike shëndetësore, mjekësore, stomatologjike, estetike, laboratorit klinik analizash dhe laboratorit stomatologjik, përfshirë gjithashtu shërbimet e imazherise etj,

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.



A handwritten signature in blue ink, reading "Brahim Shoshi". The signature is fluid and cursive, with "Brahim" on the left and "Shoshi" on the right, connected by a vertical line.

## **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote te cilat zotërohet si më poshtë: Brahim Shoshi , i datëlindjes 06.02.1987, lindur ne Bajram Curri dhe banues në Rruga Jordan Misja,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I70206067L

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

## **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruese në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë **"Rejuvence" shpk** është: Brahim Shoshi , i datëlindjes 06.02.1987, lindur ne Bajram Curri dhe banues në Rruga Jordan Misja, identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I70206067L Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 07.03.2024.  
Afati i emerimit te administratorit eshte deri me 07.03.2029.

### Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

### Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **"Rejuvence" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

### ORTAKET THEMELUES

**Brahim Shoshi**

Tiranë, më datë 07.03.2024

